

Procesverbal

Konsultim publik : *Njësia Administrative Cërravë*

Data : 17/10/2022

Ora : 12:00

Vendi: Fshati Cërravë

Numri i pjesëmarrësve : Gjithësej 26 persona të pranishëm (4 gra dhe 22 burra).

Titulli i Projekt-aktit që konsultohet : Paketa Fiskale dhe Buxheti 2023

Pjesëmarrës : **Ilir Xhakolli** (Kryetar I Bashkise)

Irsa Karapanca (Drejtoreshë Financës)

Enjela Karafili (Drejtoreshë, Drejtorja e Tatimeve)

Shpresa Blaceri (Këshilltar, Bashkia Pogradec)

Drita Seitllari (Këshilltar, Bashkia Pogradec)

Jona Bojko (Sekretare Këshilli)

Matilda Tollaku (Sekretaria e Këshillit)

- **Takimi drejtohet nga Kryetari i i cili bëri një prezantim të shkurtër në lidhje me :**
- Sistemin e Ndrimit që po adaptohet në të gjitha fshatrat e Bashkisë Pogradec
- Sistemin e Furnizimit me ujë të pijshëm të gjitha fshatrave
- Sistemin e Kanalizimeve
- Ndertimi i një pike grumbullimi në fshatin Leshnicë.

Pjesëmarrësit që morrën fjalën shprehën problematikat që ata kanë në fshatin ku jetojnë.

Ajet Cuka : Përsa i përket pikës së grumbullimit që do të hapet në fshatin Leshnicë jemi pak skeptikë sepse pika që është aktuale për grumbullim nuk i ndihmon aspak banorët për të grumbulluar mallin. Të

ketë një kriter që te marre produktet tona plus të ketë një person që të na orientojë dhe çfarë të mbjellim.

Ilir Xhakolli: Unë ju sygjeroj që të hapni një shoqatë për fermerët.

Vladimir Lipo: Linja e autobusëve në fshatin Leshnicë duhet të respektojë oraret sepse ka problem me këtë pjesë.

Kryeplaku I fshatit Blacë: Të ndërtohet një kënd lojrash për fëmijët e kopshtit.

Sotiraq Mangëri: Në fshatin Blacë do të bëhet një investim në oborrin jashtë shkollës.

Klodian Oshafi: Në fshatin Blacë duhet rrethuar shkolla sepse ka dalje në rrugë dhe është e rrezikshme për fëmijët.

Ilir Xhakolli: Po mundohemi të krijojmë një sh.a për furnizimin me dru por nuk plotësojmë dot kapacitetet.

Lulëzim Kapa: Zaptimi I kullotave të fshatit Cërrave

Fation Bardhi: Në fshatin Grabovicë ka një problem me staraqineskën e cila është e prishur.

Agron Seitelli: Është hapur një tendet në Bashki për të gjitha këto problem për ti rregulluar.

Banor I fshatit Petrushë: Në fshatin Petrushë është një lumë , në të cilin kalojnë dhe ujrat e zeza. Banorët që jetojnë atje afër përballen cdo ditë me aromat e pakëndshme . Atje duhen vetëm disa tuba të gjera dhe ti hedhim beton.

Vladimir Lipo:Rrugët e arave në fshatin Leshnicë janë të nevojshme për tu pastruar dhe hapur.

Kosta Taftirani: Në fshatin Qershize, janë problem ujrat e zeza, klasat në gjimnaz janë pa prize.

Mbajtësi i procesverbalit

Jona Bojko